Njoftim për përqendrim me të cilin ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) IV-B B.V. Amsterdam, Holandë dhe GÜLERMAK INVEST SP. Z O.O. Varshavë, Poloni do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi PPP SOLUTIONS POLSKA 2 SP. Z O.O. Varshavë, Poloni

(lënda nr. 08-158/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 11.11.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim nga ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) IV-B B.V.**,** shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Zuidplein 166, 1077 XV Amsterdam, Holandë, dhe GÜLERMAK INVEST SP. Z O.O.**,** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Varshavë, në rr. Giełdowa 7/9, 01-211 Varshavë, Poloni, me të cilin këto dy shoqëri do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi PPP SOLUTIONS POLSKA 2 SP. Z O.O.**,** Varshavë, në rr. Giełdowa 7/9, 01-211 Varshavë, Poloni.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

- **ABERDEEN INFRASTRUCTURE (HOLDCO) IV-B B.V.** është pjesë e Grupit Aberdeen. **Grupi Aberdeen** është grup ndërkombëtar global që ushtron veprimtari në fushën e investimeve, menaxhimit të aseteve dhe shërbimeve financiare.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi Aberdeen nuk ka shoqëri të varura, degë të regjistruara apo veprimtari të drejtpërdrejtë komerciale.

GÜLERMAK INVEST SP. Z O.O. është pjesë e **GRUPit GÜLERMAK**, një grup ndërkombëtar kontraktues për projektim, prokurim dhe ndërtim, i specializuar në transportin masiv dhe infrastrukturën e transportit (metro, hekurudha, tramvaje, autostrada, ura dhe tunele), si dhe në projekte të energjisë së ripërtëritshme.

Veprimtaria kryesore e **GÜLERMAK INVEST SP. Z O.O.** është mbajtja e pjesëmarrjeve dhe aktivitetet investuese në koncesionet për infrastrukturë dhe energji të ripërtëritshme.

GRUPi GÜLERMAK në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka prani lokale nëpërmjet degës së regjistruar të shoqërisë GÜLERMAK AĞIR SANAYİ İNŞAAT VE TAAHHÜT ANONİM ŞİRKETİ, Dega në Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive si kontraktues në projektin e infrastrukturës hekurudhore të Korridorit VIII (segmenti Beljakovcë).

PPP SOLUTIONS POLSKA 2 SP. Z O.O. është shoqëri me qëllim të posaçëm, e themeluar ekskluzivisht për financimin, ndërtimin, mirëmbajtjen afatgjatë dhe menaxhimin e disponueshmërisë së projektit të tramvajit „Tramvaji i Shpejtë Krakov – Faza IV“ në qytetin e Krakovit, Republika e Polonisë, i cili realizohet sipas modelit të partneritetit publiko-privat (ang.PPP).

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

13.11.2026

Shkup